



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/121

Datë: 03/07/2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, dhe pas shqyrtimit të rekomandimit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, për shkak të volumit të punës me palë, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

- I. **OBLIGOHEN**, Zyra e Gjendjes Civile, zyra pritëse, zyra e kadastrës dhe zyra e tatimit në pronë, që nga data 06.07.2026 deri më 31.08.2026 të punojnë me orar të plotë prej 08:00 deri në 16:00, për t'i pajisur me dokumente të Gjendjes Civile dhe dokumente tjera qytetarët dhe bashkëatdhetarët që vijnë nga diaspora edhe gjatë kohës së pauzës.
- II. Periudhën e pushimit të drekës, ora 12:00-13:00, t'a mbajnë në formë kujdestarie dhe secili shërbyes civil mund t'a shfrytëzojë kohën e pauzës ashtu siç e parasheh Ligji në fuqi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

ARSYETIM

Kjo zgjatje e orarit të punës bëhet duke u bazuar në fluksin më të madh të qytetarëve dhe që t'u ofrohet shërbim shtesë bashkëatdhetarëve tonë që vijnë nga diaspora për pushime në Kosovë dhe kanë nevojë për t'u pajisur me dokumente të Gjendjes Civile dhe dokumente tjera.

Të njoftohen:

- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër,
- Arkivi i Komunës së Junikut.

